

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**  
**“MARRIN” SHPK**

Sot, ne date 11.08.2025, themeluesi:

Ûmit Işık, i biri i Növfel, i datelindjes 15.06.1977 lindur ne Samandag, Turqi dhe banues ne Librazhd, Shqiperi me adrese: Dragostunje, Nd. 084, Qender Librazhd, Dragostunje 3411, Librazhd identifikuar me Pashaporte Turke me numer serie S37848410 dhe numer personal 10301375820.

Ne perputhje me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008, i ndryshuar si edhe Ligjin nr.9723, date 3.5.2007, nenet 26, 28, 32 e 35 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ka vendosur te themeloje Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar **“MARRIN” SHPK**.

**Neni 1.**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqeria do te quhet **“ MARRIN ” SHPK**.

**Neni 2**

**SELIA E SHOQERISË**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Lagja nr.1, Rruga Nacionale me zone kadastrale 2446, nr pasurie 8/407, Kati 4, hyrja Nr.8, Librazhd. Shoqëria mund te hape filiale te tjera në te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe në të gjitha shtetet jashte territorit te Republikes se Shqiperisë.

**Neni 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQERISË**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jetë: Import eksport, blerje shitje marketing e te gjitha llojeve te makinerive industriale dhe te punes, pjeseve te kembimit, paisjeve dhe ekipamenteve te tyre, prodhim i makinerive per perpunimin e aluminit, drurit, PVC dhe makinerive prerese dhe shpuese te perdorura ne industri, prodhim i makinerive hidraulike, cilindrave hidraulike, makinerive pneumatike, motoreve hidraulike dhe automatike, si dhe pjeseve lidhese, prodhim, riparim dhe montim i te gjitha llojeve te makinerive dhe veglave elektrike dhe elektronike, prodhimi i te gjitha llojeve te makinerive per perpunimin e tekstileve (makinat e ramit, pergatitjen e pelhurave, makinat e kthimit, makinat e ngjyrosjes, makinat centrifugale, makinat e hapjes se lagesht, makinat e hapjes se thate, makinat e shtypjes, prerjes, tharjes, makinat sanfor, prodhimi i paneleve elektrike dhe elektronike per keto makina, si dhe prodhimi, blerja shitja importi dhe eksporti i te gjitha materialeve dhe pjeseve te ketyre makinerive, prodhimi dhe marketingu i te gjitha llojeve te makinerive dhe materialeve per ashensore, si dhe shitja me shumice dhe pakice etj.



#### **Neni 4**

### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISË**

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (njqindmije) Leke. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e meposhtem qe nenkuptohet i perbere nga 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke. Kjo kuote i perket ortakut si me poshte:

**Ûmit Işık**, zoterues i 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke me pjesmarrje 100% ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

#### **Neni 5**

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISË**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

#### **Neni 6**

### **ADMINISTRIMI I SHOQERISË**

Administrator i shoqerise do te jete z. **Ûmit Işık** identifikuar me Pashaporte Turke me numer serie S37848410 i cili emerohet per nje periudhe 5-vjecare, me te drejte rizgjedhje. Nje Administrator tjeter mund te emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Administratori ka te gjithë kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te trete ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

#### **Neni 7**

### **VENDIME TE ASAMBLESE SE PERGJITHESHME**

Asambleja e pergjitheshme eshte organi me i larte vendimmarres.

Vendimet e asamblese se pergjitheshme merren bazuar ne perqindjen e kapitalit e zoteruar prej secilit ortak, konform pikes 1, neni 86 i ligjit 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.

Te gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjitheshme regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.



## **Neni 8**

### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi do te shperndahet midis ortakeve respektivisht sipas kuotave te kapitalit themeltar te investuar te shprehura ne nenin 4 te ketij akti. Fitimi i destinuar per tu shperndare perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven ligjore dhe te tjera rezerva statutore, si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e meparshme.

## **Neni 9**

### **LIKUIDIMI**

Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj, operacion i cili do te kryhet sipas kerkesave te parashikuara ne legjislacionin tregtar shqiptar.

## **Neni 10**

### **MOSMARRËVESHJET**

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, themeluesi do t'i drejtohet Gjykates se Rrethit per zgjidhje.

## **SHOQËRIA ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR**

### **“MARRIN” SHPK**

**Ortaku**

**Ümit Işık**

*Me Përkrahje nënkupton*  
*Av. Feriati Rrogo*  
*[Signature]*